

dhe djali i vëllait të tij, Sejdiu, u inkuadruan në UÇK më 2.04.1998. Atë ditë, në fshatin e tyre **[Smolicë/Smonica]**, u themelua një njësit i UÇK-së. Avdyli e kishte për detyrë mbajtjen e rojës në fshat. Më **17.07.1998**, nga ora 08:00, pjesëtarë të forcave serbe e sulmuan fshatin me predha. Avdyli e mbante pozicionin në oborrin e vet, pas një muri. Afro njëzet minuta pas fillimit të sulmit, një granatë ka eksploduar në afërsi të tij dhe i ka shkaktuar plagët vdekjeprurëse. Po atë ditë, familjarët e kanë varrosur Avdylin në një fushë. Pas përfundimit të luftës, më 20.10.2000, mbetjet e tij mortore janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Smolicë/Smonica.

Burimet: deklarata S.H, FDH-29797; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; KMDLNJ, *Buletini*, num.9, tetor-dhjetor 1998, 204, FDH-23857.

Ilmi (Sadri) Malushaj

(13.07.1964, shqiptar nga Kotradiqi/Kotradić, komuna e Pejës/Peć, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Nazmi (Haxhi) Muzliaj

(12.08.1966, shqiptar nga Orrobërda/Orno Brdo, komuna e Istogut/Istok, student, pjesëtar i UÇK-së)

Agron (Sadik) Krasniqi

(1.09.1967, shqiptar nga Llapushniku/Lapušnik, komuna e Glogocit/Glogovac, mekanik, pjesëtar i UÇK-së)

Adem (Ramadan) Ademi

(1.08.1969, shqiptar nga Galica, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Abdullah (Adem) Qerkezi

(25.11.1969, shqiptar nga Obiliqi/Obilić, student, pjesëtar i UÇK-së)

Bashkim (Idriz) Kerolli

(30.12.1971, shqiptar nga Polaci/Poljance, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, pjesëtar i UÇK-së)

Shefqet (Rexhep) Seferi

(6.03.1976, shqiptar nga Grejçefci/Grejčevce, komuna e Suharekës/Suva Reka, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Visar (Sabit) Thaçi

(31.10.1976, shqiptar nga Podujeva/Podujevo, punëtor, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Nimon (Musë) Demaj

(7.05.1978, shqiptar nga Vrella/Vrelo, komuna e Istogut/Istok, pjesëtar i UÇK-së)

Bekim Nezir Tovërlani

(6.10.1978, shqiptar nga Klinaci/Klinavac, komuna e Klinës/Klina, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Arton (Sheh) Zogaj

(20.1.1979, shqiptar nga Orrobërda/Orno Brdo, komuna e Istogut/Istok, student, pjesëtar i UÇK-së)

Ilmiu e kishte mbaruar shkollën e mesme. Merrej me bujqësi. Ka marr pjesë në themelimin e shtabit lokal të UÇK-së në Kotradiq/Kotradić. Nazmiu ka qenë absolvent i Fakultetit Juridik në Prishtinë/Priština. Aderoi në radhët e UÇK-së më 6.07.1998. Artoni, 19 vjeç, ka qenë student i vitit të parë të Fakultetit Ekonomik në Prishtinë/Priština kur, në muajin qershor të vitit 1998, aderoi në UÇK. Nimoni u inkuadrua në UÇK në fillim të vitit 1998. Bashkimi hyri në radhët e UÇK-së pas vrasjes së anëtarëve të familjes Ahmeti në Likoshan/Likošane, në shkurt të vitit 1998 [të shikohet regjistrimi në faqet 83-87], ndërkaq Agroni e bëri këtë në muajin mars, e Ademi dhe Nazmiu në muajin korrik të vitit 1998. Për një kohë, Shefqeti, Bekimi, Visari dhe Abdullahu kanë jetuar jashtë Kosovës. Visari u kthye në Kosovë në fund të muajit maj, Shefqeti dhe Abdullahu në qershor, ndërkaq Bekimi në fillim të korrikut të vitit 1998. Që të gjithë menjëherë u inkuadruan në UÇK.

Herët në mëngjes nga ora 02:00, në datën **17.07.1998**, Bashkimi, Ademi, Agroni, Ilmiu, Nazmiu, Abdullahu, Shefqeti, Visari, Nimoni, Bekimi dhe Artoni, së bashku me një grup të madh të luftëtarëve të UÇK-së, e kanë kaluar kufirin me Shqipërinë te vendi i quajtur *Rrasa e Zogut/Ptičiji kamen* **[Koshare/Košare]**. Për detyrë e kishin ta bartnin një ngarkesë armatimesh nga Shqipëria në Kosovë. Por, kanë rënë në pusi të forcave serbe, pjesëtarët e të cilëve hapën zjarr të fuqishëm mbi pjesëtarët e UÇK-së. Bashkimi, Ademi, Nimoni, Ilmiu, Nazmiu, Visari, Agroni, Abdullahu dhe Artoni u qëlluan për vdekje në vend. Kufomat e të vrarëve kanë mbetur atje,